



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. Nr. 765/22**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje nga Vedat Poterqoi-Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani-Anëtare dhe Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë "INSI" sh.p.k me seli Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Master plani për rigjenerim të lagjes Kodra e Trimave" me numër të prokurimit 616-22-9251-2-1-1, iniciuar nga Komuna e Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 29.03.2023, mori:

#### **V E N D I M**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE "Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë "INSI" sh.p.k. me seli Prishtinë, e parashtruar në OSHP me 15.12.2022 (Protokolli Nr.765/22), kurse Vendimi i AK për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Master plani për rigjenerim të lagjes Kodra e Trimave" me numër të prokurimit 616-22-9251-2-1-1, i komunikuar me Njoftimin e datës 02.12.2022, Mbetet në fuqi.

2. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës konform nenit 31 pika 5 të Rregullores për Punën e OSHP;

#### **A r s y e t i m**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 15.12.2022, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar nga "Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë "INSI" sh.p.k. në cilësinë e OE, ankesë (numër protokollit 765/2022) për aktivitetin e prokurimit me titull "Master plani për rigjenerim të lagjes Kodra e Trimave" me numër të prokurimit 616-22-9251-2-1-1.

Aktiviteti i prokurimit në këtë rast (i përshkruar si më sipër me emërtim dhe numër) është iniciuar nga Komuna e Prishtinës, e cila duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka aplikuar procedurë e hapur (sikurse përkufizohet me nenin 4, paragrafi 1.37, të LPP); natyra e punëve: shërbime; kurse vlera e parashikuar e kontratës i referohet shumës: 400,000.00 €;

Me 02.12.2022, Autoriteti Kontraktues (me të dhënat si më sipër) përmes Njoftimit publik e ka komunikuar Vendimin, sipas të cilit për zbatimin e projektit lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, e ka rekomanduar OE “GM Architecture” sh.p.k.

Me 06.12.2022, tani ankuesi, ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK, të datës 08.12.2022;

Me 15.12.2022. tani ankuesi ka parashtruar Ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit, duke e atakuar Vendimin e AK për dhënie të kontratës, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, i cili është komunikuar sipas Njoftimit të datës 02.12.2022.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

*Me fazën e shqyrtimit paraprak, OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Ankuesi ka statusin e palës (palë me interes), sikurse parashihet me paragrafin 1.26, të nenit 4, lidhur me nenin 103 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP.*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka mandatuar Panelin Shqyrtues sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 lidhur me nenin 114 të Ligjit të cituar, ta bëjë analizën fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 20.12.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e shqyrtimit fillestar me rekomandime, sikurse kërkohet me paragrafin 2, të nenit 114, të LPP, të cilat përshkruhen si në vijim:

- Të refuzohet ankesa si e pa bazuar,
- Të mbetet në fuqi Vendimi i Autoriteti Kontraktues;

Raporti i cituar si më sipër përmban elementet qenësore dhe i njëjti i është dërguar autoritetit kontraktues dhe ankuesit, sikurse kërkohet me paragrafin 3 të nenit 19, të Rregullores për Punën e OSHP. Njëherësh konstatohet se palët janë të informuara me kohë dhe disponojnë në mënyrë identike me të gjitha shkresat e kësaj lënde (nga platforma e prokurimit elektronik) në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregulloreje, prandaj ka kushte që përkitazi me ankesën në rastin konkret të inicohet procedura për vendosjen meritore.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

Paneli Shqyrtues, konstatoi më parë se nuk ekzistojnë elementet për konflikt të interesit, sikurse parashihet me paragrafin 1.74, të nenit 4, të LPP lidhur me nenin 11 të Rregullores për Punën e

OSHP dhe analizoi në vijim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka prova të mjaftueshme për të vendosur lidhur me ankesën, dhe ka mbajtur seancë më dt. 24.03.2023, me qëllim të vërtetimit të drejtë të çështjes. Paneli shqyrtues pas administrimit të gjithmbarshëm të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore, analizës dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues dhe deklarimeve të palëve, konstaton se:

Ankuesi e ka atakuar Vendimin e cituar si më sipër të Komunës së Prishtinës, e cila duke vepruar nga cilësia e sajë si autoritet kontraktues, e ka refuzuar ofertën, respektivisht tenderin e ankuesit me arsyetimin, sikurse pëshkruhet në vijim: “...menaxher të projektit keni caktuar personin me profesion urbanist e jo inxhinier i ndërtimtarisë ose arkitekturës siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit dhe për këtë arsye është refuzuar tenderi juaj”.

Ekspertit shqyrtues duke u bazuar në analizën e dokumenteve të publikuara në platformën e sistemit elektronik [e-prokurim] dhe të dedikuara për këtë aktivitet të prokurimit ka shpjeguar se AK në njoftimin për kontratë (NJK) dhe dosjen e tenderit (DT) lidhur me përmbushjen e kriterve si në vijim *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale*, të parapara me neni 9.1 & 9.2 III.2.4, dhe *Kapaciteti teknik dhe profesional*, kërkesa 2, është kërkuar sikurse përsëritet po ashtu si në vijim:

OE duhet te ofrojnë dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon: Menaxheri i projektit Inxhinier i ndërtimtarisë ose arkitekturës; 5 vite përvojë pune; ndërsa si dëshmi të kërkuara përsëriten: CV, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

Duke ju referuar pretendimit ankimor si më sipër, Eksperti shqyrtues ka shpjeguar se ankuesi me ofertën e tij (dorëzuar përmes platformës elektronike) lidhur me kërkesën e paraparë në DT për Menaxher të Projektit, i cili është kërkuar të jetë Inxhinier i Ndërtimtarisë ose Arkitekturës dhe me 5 vite përvojë, ka dorëzuar anëtarin e stafit profesional<sup>1</sup> i cili ka ndjekur kursin në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në Degën Arkitektura dhe është pasjitur me titullin Urbanist (Shih: Diploma nr. 3030, datë 06.04,1999, numër regjistri 2512, Fakulteti, Universiteti-Dega dhe titulli i fituar).

Në vijim, eksperti ka shpjeguar se kandidati në rastin konkret, i prezantuar në ofertë për plotësimin e kërkesave të cituara si më sipër, mban titullin Urbanist, e jo Inxhinier i arkitekturës sikurse është kërkuar me DT dhe NJK. Në Raportin e ekspertizës është shpjeguar po ashtu se, kandidati ka marrë Gradën Shkencore Doktor me 30.01.2017, kurse me 24.07.2017, ka marrë licencën profesionale në fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrja e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit, licenca nr. A.1660/1, në projektim, me ç'rast edhe në këtë licencë përsëritet se është i Diplomuar më 1999 me titullin Urbanist. Në kontekstin e fakteve dhe provave të shpjeguara si më sipër, eksperti ka shpjeguar se kandidati apo personi në rastin konkret, i prezantuar në ofertë për plotësimin e kërkesave të cituara si më sipër, pavarësisht gradave shkencore, nuk e plotëson kërkesën e AK,

---

<sup>1</sup> Të dhënat personale në shikesa të lëndës

sikurse është kërkuar me DT dhe NJK. Krahas tjerash, eksperti shqyrtues e ka prezantuar Programin Mësimor të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës të Universitetit Politeknik të Tiranës, të Departamentit të Arkitekturës. Dega: Arkitekture, Profili : Arkitekt / Urbanist, 5 vite studimi si dhe të Departamentit të Urbanistikës, Dega Arkitekture Profili Urbanist 5 vite studim. Prandaj bazuar në të lartëcekutat dhe nisura nga pikëpamja e ekspertit shqyrtues, kuptohet se ky pretendim ankimor është cilësuar si i pa bazuar.

*-Konstatimet e Panelit shqyrtues-*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, sa i përket çështjes kontestuese lidhur me kërkesën mbi mundësit teknike dhe profesionale për inxhinierinë e ndërtimtarisë ose arkitekturës, me datën 13.02.2023, Paneli Shqyrtues i është drejtuar (me anë të postës elektronike) Fakultetit të Inxhinierisë dhe Ndërtimit të Universitetit të Tiranës, me kërkesën si në vijim, cituar:

Nëse një person ka përfunduar studimet në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit-Universiteti Politeknik i Tiranës, në Degën Arkitekturë, duke e marr titullim URBANIST, a konsiderohet se personi në fjalë është Inxhinier i Ndërtimtarisë, Inxhinier i Arkitekturës apo çfarë titulli merr personi në fjalë. Pra, personi në fjalë, sipas dëshmisë si me poshtë a konsiderohet se është Inxhinier i Ndërtimtarisë, Inxhinier i Arkitekturës, apo çfare tituli merr personi ne fjale.

Me 14.02.2023, Universiteti i Tiranës, përmes Koordinatorës për të drejtën e informimit, ka dërguar përgjigje duke shpjeguar si në vijim:

Sikurse ju sqaruam ne e-mailin e datës 14.02.2023, studentet e diplomuar përpara vitit 2013 ne Fakultetin e Inxhinierisë se Ndërtimit, Universitetin Politeknik i Tiranës ne degën Arkitekture mund te merrnin titullin "Arkitekt" ose "Urbanist". Edhe pas krijimit te Fakultetit te Arkitekturës dhe Urbanistikës ne vitin 2013 dhe ne vijim, studentet e diplomuar ne këtë fakultet marrin titullin "Arkitekt" ose "Urbanist".

Duke ju referuar përgjigjes si më sipër, Paneli Shqyrtues konsideron se studentët e diplomuar në Universitetin e cituar, po ashtu si më sipër, marrin titullin: Arkitekt ose Urbanist. Andaj, duke i analizuar të dhënat nga dokumentet si më sipër, Paneli shqyrtues ka krijuar mendimin e pavarur të tij/sajë se ankuesi e ka ofruar si Menaxher projekti, personin e diplomuar me titull Urbanist, e jo Arkitekt ashtu siç ishte kërkuar shprehimisht me DT. Për këto arsye, Paneli vendosi që ta mbështes mendimin e ekspertit profesional dhe rekomandimin e tij.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës, Paneli konstatoi se pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, i referohen në fakt nenit 41 (Njoftimi mbi dhënien e kontratës) të LPP, sipas të cilit autoriteti kontraktues ka dhënë përfundimisht një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura në pajtim me nenin 4. 1.37, lidhur me nenin 32 dhe 33 të LPP. Kurse kriterët e parashikuar janë vendosur në NJK dhe në DT, në pajtim me nenin 27 dhe 28 të LPP. Paneli konsideron se në

kontekstin integral të LPP, AK ushtron pavarësinë institucionale lidhur me planifikimin e prokurimit dhe nevojat që duhen përmbushur (nenet 8, 9 të LPP) në raport me kapacitetet buxhetore, kurse DT përbën dokumentin qenësor të aktivitetit të prokurimit dhe për hirë të sigurisë juridike, me paragrafin 3, të nenit 7 të LPP, çdo AK i ndalohet shprehimisht çdo shmangje nga termat dhe kriteret e precizuara në DT, sepse sipas paragrafit 1, të nenit 27, kanë karakter material, kurse devijimi eventual atakon parimin e barazisë sikurse sanksionohet me nenin 7 të LPP. Prandaj në kuptimin integral të nenit 28, kuptohet se AK ka të drejtë të përdorë standarde, terma, kritere dhe/ose specifikime, meqë sipas paragrafit 10 të kësaj dispozite është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutiv.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 të LPP kurse pohimet ankimore në këtë rast nuk ofrojnë argumente jo-kontestuese në raport me vendimin e atakuar të AK, prandaj Paneli, sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP, konsideron se i njëjti duhet mbetur në fuqi dhe se kthimi i një aktivitetit të prokurimit në ri-vlerësim, në mungesë të provave bindëse nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues  
Vedat POTERQOI

#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- AK - Komunës së Prishtinës
- OE- Ankuesit
- Arkivës së OSHP;
- Për publikim në ueb-faqe